



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë më ____ . ____ .2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Data 20.08.2024

Drejtuar: Blerina Sadiku p.f., me NIPT K97730102T

Adresa: Berat, Perondi MAGJATE Godinë 1 katëshe në Magjatë pranë Ish-Uzinës së Aviacionit

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje këpucësh për Gardën e Republikës”, me fond limit në vlerën 19,998,038 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, me afat të marrëveshjes kuadër 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes.

Numer reference REF-09044-06-11-2024

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Blerina Sadiku p.f.,
Emri i plotë i shoqërisë

K97730102T
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 19,963,600 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH;

2. Armand Sinani p.f.
Emri i plotë i shoqërisë

L22301008D
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar:14,998,616 (katërmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

3. Bledi Loçi p.f
Emri i plotë i shoqërisë

L47401203N
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 19,984,880 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH;

4. UNIVERS PROMOTIONS sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K81324039M
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 16,937,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH;

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

1. Armand Sinani p.f.
Emri i plotë i shoqërisë

L22301008D
Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “Armand Sinani” p.f. me NUIS L22301008D, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:

- Nuk plotëson pikën 4, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me mostrat e kërkuar për artikujt, ku kërkohej: “4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë, në datën dhe orën e hapjes së tenderit, mostrat e artikujve dhe të lëndës së parë, si më poshtë vijon:

a) Mostrat/Artikulli Kepuce me qafa shërbimi e stërvitje

- I(një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- I (një) copë lekurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.
- I(një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit të trupezuar.

Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

b) Mostrat Artikulli Kepuce me qafa dimri

- I(një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.

- 1 (një) copë lekurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.
- 1(një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit të trupezuar.

Lëkura e mostrës, lendës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

c) Mostrat / Artikulli Këpucë gjysma uniforme

- 1(një) palë këpucë Nr. 42. Mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- 1 (një) copë lekurë natyrale boks vici me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit, të trupëzuar.
- 1(një) cope astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etikete orgjinale të ofertuesit të trupëzuar.

Lëkura e mostrës, lendës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3, Tiranë.

Mungesa e mostrës, lëndës parë dhe fletë analizës (sipas kriterit nr.5) që shoqëron ato është kusht skualifikues.

Per kete pike KVO konstaton se OE nuk ka paraqitur moster Astar Meshini per secilin nga produktet : 1-Astar Meshini per kepuce Gjysmëuniforme , 2-Astar meshini per *Kepuce me qafa shërbimi e stërvitje* ,3-Astar meshini per *Kepuce me qafa dimri*, por ka paraqitur vetem nje moster astar , duke mos e plotesuar kerkesen sipas pikes 4 te seksionit 2.3 (Kapaciteti teknik) te Kërkesave të vecanta per kualifikim. KVO arsyeton se kjo kerkese duhej te zbatohet detyrimisht për arsye se treguesi teknik te astarit jane te ndryshem per secilen nga llojet e kepuceve. Konkretisht në fletë analizat e astarit meshin të paraqitura ne SPE nga OE rezulton se:

Nr 5 i flete analizave (*percaktimi i qëndrueshmërisë se faqes gjatë përkuljes*) te astarit meshin (L2-93 , L2-92 dhe L2-88) , rezulton me te dhena te ndryshme per te tre flete analizat , qe con në përfundimin që analizat L2-93 , L2-92 dhe L2-88 , jane kryer me Astar Mershin te ndryshem dhe jo me te njejtin Astar Meshin.

- Nisur nga verifikimi i fletë analizave të (lekurë natyrale boks viçi) paraqitura ne SPE me nr L2-91, rezulton se për artikullin (kepuçë me qafa dimri) nuk ka te dhena per piken nr 14 (percaktimi i përqindjes së yndyrës) , qe con në mospërmbushjen e kriterëve të cilesisë së pare të kërkuar për materialin lëkurë natyrale boks viçi.
- Nisur nga verifikimi i fletë analizave të (astar meshin dhie) paraqitura ne SPE me nr L2-92, rezulton se për artikullin (kepuçë me qafa dimri) nuk ka te dhena per piken nr 4 (percaktimi i mos regjies) , e cila sipas specifikimeve duhej të ishte Kromike , qe con në mospërmbushjen e kriterëve të cilesisë së pare, të kërkuar për materialin astar meshin dhie.

Nga sa me sipër OE “Armand Sinani” P.f , s’kualifikohet

2. Bledi Loçi p.f.

L47401203N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “Bledi Loçi” p.f. me NUIS L47401203N, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:

- Nuk plotëson pikën 1, të seksionit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pasi nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023).
- Nuk plotëson pikën 2, të seksionit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pasi nuk ka paraqitur kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023).
- Nuk plotëson pikën 1, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Nuk plotëson pikën 2, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi ky operator nuk ka deklaruar sipas tabelës 1 nëse është prodhues ose sipas tabelës 2 nëse është tregtues i autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi.
- Nuk plotëson pikën 4, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuar për artikujt, Kepucë me qafa shërbimi e stërvitje / Kepucë me qafa dimri / Këpucë gjysma uniforme.
- Nuk plotëson pikën 5, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës) të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lëkurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Nuk plotëson pikën 9, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi referuar formularit të vetëdeklarimit rezulton se ky operator nuk disponon numrin minimal të punonjësve të kërkuar.

Nga sa me sipër OE “Bledi Loci”, s’kualifikohet

3. UNIVERS PROMOTIONS sh.p.k.,

K81324039M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

1. Operatori ekonomik “UNIVERS PROMOTIONS” sh.p.k., me NUIS K81324039M, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT, argumentuar si vijon:

- Nuk plotëson pikën 4, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, lidhur me mostrat e kërkuar për artikujt, Kepucë me qafa shërbimi e stërvitje / Kepucë me qafa dimri / Këpucë gjysma uniforme.
Referuar kërkesës, operatorët ekonomikë për secilin nga artikujt e mësipërm duhej të paraqisnin:

- 1 (një) palë këpucë Nr 42, mostra duhet të ketë të trupezuar vulen dhe etiketen orgjinale të fabrikes prodhuese.
- 1 (një) copë lëkurë natyrale lëkurë viçi (boks) cilësia e parë me përmasa 30 x 30 cm, me vulë dhe etiketë orgjinale të ofertuesit, të trupezuar.
- 1 (një) copë astar meshini dhie, me përmasa 30 x 30 cm me vulë dhe etiketë origjinale të ofertuesit të trupezuar.

Lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

OE “UNIVERS PROMOTION” nuk ka te trupezuar ne mostrat e paraqitura prane autoritetit kontraktor vulen dhe etiketen origjinale te fabrikes prodhuese “GIASKO” per te cilen ka autorizim, por ka te trupezuar stema që nuk kane lidhje me prodhuesin me te cilin është lidhur autorizimi.

- Nuk plotëson pikën 5 të seksionit 2.3 të Kapacitetit Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit ku kërkohet që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës) të treguesve fiziko–mekanik e kimik të lëndës së parë lëkurë natyrale boks vici dhe astarit meshin dhie, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Tëst raport të paraqitura nga ky ofertues janë të vitit 2017 dhe nuk plotësojnë kërkesën e pikës 4, të seksionit 2.3 Kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit ku parashikohet që lëkura e mostrës, lëndës së parë dhe ajo që i bashkëngjitet raport-analizës (sipas kriterit nr.5) duhet të jenë detyrimisht të njëjta.

Ne raport analiza nuk eshte bashkangjitur lenda e parë

OE UNIVERS PROMOTION , s’kualifikohet

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. Blerina Sadiku p.f.,
Emri i plotë i shoqërisë

K97730102T
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 19,963,600 (nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH;

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek *Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adrese Adresa: Rr."Reshit Çollaku", Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*, brenda 10 (dhjete) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR